



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE
LARGIMIT E PËRPUNIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA
KOMISIONI KOMBËTAR RREGULLATOR

VENDIM
Nr.22, datë 20.07.2026

PËR
FILLIMIN E PROCEDURËS PËR RISHIKIMIN E METODOLOGJISË DHE
PROCEDURËS PËR MIRATIMIN E TARIFAVE TË SHËRBIMEVE UJËSJELLËS
KANALIZIME

Në mbështetje të nenit 13, 14, 21 dhe 22 të ligjit nr. 8102 datë 28.03.1996 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", i ndryshuar (ligji nr. 8102),

Komisioni Kombëtar Rregullator,

në mbledhjen e datës 20.07.2026 pasi shqyrtoi informacionet e paraqitura nga Drejtoria Tekniko-Ekonomike, Nr.505 Prot, datë 14.07.2026 "Mbi situatën e aplikimeve të Shoqërive Rajonale UK për nivel të ri tarifar" dhe Nr.506 Prot, datë 14.07.2026 "Mbi nevojën për rishikimin e disa dispozitave të Metodologjisë dhe Procedurës për Miratimin e Tarifave të Shërbimeve Ujësjiellës Kanalizime",

Konstaton se:

1. Bazuar në pikën 4 të nenit 10 të Metodologjisë dhe Procedurës për Miratimin e Tarifave të Shërbimeve Ujësjiellës Kanalizime përcaktohet se afati përfundimtar për paraqitjen e dokumentacionit të plotë të aplikimit për nivel të ri të tarifave është data 30 qershor.
2. Në pikën 1 të nenit 11 përcaktohet se periudha rregullatore është periudha gjatë së cilës ERRU përcakton parametrat kryesorë për funksionimin e shoqërisë, objektivat që duhet të përmbushë për rritjen e nivelit të shërbimit, si dhe planin tarifar që ajo duhet të ndjekë gjatë gjithë periudhës, pas së cilës shoqëria UK është e detyruar të aplikojë për tarifa të reja të ndryshuara. Mos aplikimi për tarifa të reja pas përfundimit të periudhës rregullatore do të bëhet shkak për marrjen e masave administrative sipas parashikimeve të ligjit nr. 8102.
3. Referuar informacionit Nr.505 Prot, datë 14.07.2026 "Mbi situatën e aplikimeve të Shoqërive Rajonale UK për nivel të ri tarifar" evidentohet se aplikimet e paraqitura për vitin 2026 për nivel të ri tarifar kanë mungesa të plotësimi të dokumentacionit sipas nenit 10 të metodologjisë. Gjithashtu, shoqëritë UK kanë paraqitur kërkesën pranë ERRU-se për shtyrje të afatit të dorëzimit të dokumentacionit të plotë të aplikimit.

4. Nëpërmjet shkresës nr. 2199 prot, datë 01.06.2026, me lëndë “Kërkesë për shqyrtimin dhe miratimin e aplikimit të mekanizmit të tarifimit me fasha konsumi si masë e domosdoshme për garantimin e furnizimit të qëndrueshëm me ujë në zonat me ngarkesë të lartë turistike dhe sezonale”, protokolluar me tonën me nr. 428 prot, datë 02.06.2026, Agjencia Kombëtare Ujësjiellës Kanalizime ka paraqitur pranë Entit Rregullator të Ujit kërkesën për shqyrtim dhe një relacion nëpërmjet të cilit propozon aplikimin e një mekanizmi sezonal tarifimi me fasha konsumi për SHRUK Durrës, Vlorë dhe Sarandë, me qëllim menaxhimin e kërkesës për ujë gjatë periudhës së ngarkesës së lartë turistike.
5. Referuar informacionit të përgatitur nga Drejtoria Teknike Ekonomike Nr.506 Prot, datë 14.07.2026 propozohet:
 - a. Përshtatjen e afateve dhe procedurave të aplikimit me praktikën reale të sektorit dhe ndryshimin e afatit të aplikimit për tarifa, duke përcaktuar datën 30 nëntor si afatin përfundimtar për paraqitjen e dokumentacionit të aplikimit.
 - b. Parashikimin e një periudhe tranzitore për shoqëritë, periudha rregullatore e të cilave përfundon përpara hyrjes në fuqi të vendimit të ri tarifor. Gjatë kësaj periudhe, shoqëritë do të vazhdojnë të zbatojnë tarifat, strukturën tarifore dhe të gjitha kushtet e përcaktuara në vendimin e fundit të miratuar nga Komisioni Kombëtar Rregullator, deri në hyrjen në fuqi të vendimit të ri. Kjo periudhë tranzitore të mos zgjasë më shumë se 1 vit.
 - c. Rregullimin e rasteve kur shoqëritë nuk kërkojnë ndryshim të nivelit tarifor në përfundim të periudhës rregullatore. Përcaktimin e detyrimit që shoqëritë, të cilat në përfundim të periudhës rregullatore nuk paraqesin kërkesë për ndryshimin e nivelit tarifor, të paraqesin pranë ERRU-së një analizë tekniko ekonomike, të miratuar nga Këshilli i Administrimit/Mbikëqyrës. Për shoqëritë, të cilat sipas analizës mbulojnë kostot O&M deri në 100%, mund të vijojnë me të njëjtin plan për një periudhë maksimale deri në dy vite. Vendimarrja mbi afatin mbetet e KKRR. Për shoqëritë të cilat, nivelet e mbulimit të kostove O&M mbi 100%, mund të vijojnë me të njëjtin nivel tarifor 1 vit, pasi për këto shoqëri është e nevojshme që të bëhet analizë e mirëfilltë sipas dispozitave të kësaj metodologjie.
 - d. Krijimin e bazës rregullatore për aplikimin e mekanizmave tariforë specifikë, si tarifimi me fasha/blloqe konsumi, në rastet kur këto justifikohen nga kushte të veçanta operative dhe janë në interes të garantimit të furnizimit të qëndrueshëm me ujë, por njëkohësisht i shërbejnë ruajtjes së burimeve dhe rezervave ujore.

Komisioni Kombëtar Rregullator pasi vlerësoi se ndryshimet e propozuara do të kontribuojnë në përmirësimin e procesit të aplikimit për tarifa, rritjen e cilësisë së dokumentacionit të paraqitur nga shoqëritë dhe garantimin e një procesi rregullator më efikas, transparent dhe të zbatueshëm në praktikë si dhe në zbatim të pikës 1 të nenit 14, të pikës 1 të nenit 21 dhe të pikës 1 të nenit 22 të ligjit nr. 8102 datë 28.03.1996 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", i ndryshuar

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurës për rishikimin e metodologjisë dhe procedurës për miratimin e tarifave të shërbimeve ujësjellës kanalizime.
2. Ndryshimet e propozuar në metodologji duhet të përfundojë brenda datës 15.09.2026.
3. Për vitin 2026, afati i plotësimit të dokumentacionit të aplikimeve për nivel të ri tarifar do të jetë data 30.11.2026.
4. Ngarkohet Drejtoria Tekniko-Ekonomike për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI

Gerta Lubonja **Kryetar**

Ediola Braha **Anëtare**

Hermon Bonati **Anëtar**